

FJALA E GVERNATORIT

Zhvillimet ekonomike botërore po konturohen gjithnjë e më shumë nga rritja e çmimeve të karburanteve dhe të lëndëve të tjera bazë, si pasojë e konfliktit në Lindjen e Mesme. Në mënyrë të natyrshme, fokusi i këtij raporti tremujor ka qenë si vlerësimi i pasojave të pritura të tij në ekonominë shqiptare ashtu edhe identifikimi i reagimit të duhur të politikës monetare.

Në vija të përgjithshme, analiza e informacionit të disponuar sugjeron se ekonomia shqiptare po përballet me këtë situatë të papritur nga pozita relativisht më të shëndosha se ato që kemi pasur në përballjen me goditjet paraardhëse të pandemisë dhe të konfliktit në Ukrainë.

Së pari, ekonomia shqiptare ka pasur një trend pozitiv zhvillimi, trend i cili është manifestuar në norma solide të rritjes ekonomike, të rritjes së punësimit në sektorin privat jobuqësor dhe të pagave. Kjo ecuri është pasqyruar në përmirësim të bilanceve financiare të familjeve dhe të bizneseve dhe në një situatë pozitive likuiditeti në ekonomi.

Së dyti, treguesit kryesorë të stabilitetit ekonomik e financiar shfaqen të përmirësuar. Inflacioni, për momentin, vijon të shfaqet i ulët dhe nën kontroll. Ndër të tjera, nivelet e ulëta të inflacionit pasqyrojnë edhe politikën e kujdesshme dhe konsistente monetare të ndjekur nga Banka e Shqipërisë. Po ashtu, borxhi i huaj dhe borxhi publik janë reduktuar ndjeshëm gjatë tre viteve të fundit, tregjet financiare janë të qeta dhe funksionale, sektori bankar është likuid, rentabël dhe i mirëkapitalizuar, ndërsa rezervat valutore të Bankës së Shqipërisë janë në rekorde historike, të mjaftueshme për të përballuar goditje serioze.

Së treti, dhe po aq e rëndësishme, ekonomia shqiptare ka fituar një eksperiencë pozitive në administrimin e këtyre goditjeve, si në terma të politikave publike ashtu edhe në vendimmarrjen individuale të bizneseve dhe familjeve, duke shfaqur një rezistencë dhe fleksibilitet të admirueshëm.

Të gjithë këta faktorë ofrojnë një premisë inkurajuese për përballimin e rritjes së çmimeve të karburanteve dhe të lëndëve të tjera bazë si pasojë e konfliktit në Lindjen e Mesme. Megjithatë, ato nuk përjashtojnë për asnjë moment nevojën për mbikëqyrje të vazhdueshme dhe për reagim në kohë nga të gjithë aktorët.

Në rrethanat aktuale, parashikimi me saktësi i zhvillimeve të ardhshme shoqërohet nga pasiguri të larta. Ajo që është e qartë është se pasojat e goditjes do të marrin formën e një norme më të lartë inflacioni dhe të një norme më të ulët të rritjes ekonomike krahasuar me parashikimet tona të mëparshme.



Megjithatë, pritjet tona të skenarit bazë, pritje të cilat faktorizojnë një përfundim të shpejtë dhe me kosto të ulët të konfliktit, sugjerojnë se ndikimi në inflacion dhe në rritjen ekonomike do të jetë afatshkurtër dhe marginal. Bazuar në këto konsiderata, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mbajë të pandryshuar qëndrimin e politikës monetare në mbledhjen e datës 6 maj. Ky qëndrim, i ngjashëm me reagimin e bankave të tjera qendrore, ofron një balancë të mirë midis pasigurive dhe rreziqeve që ekzistojnë për të ardhmen.

Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë mbetet e angazhuar edhe në vlerësimin e skenarëve të tjerë të mundshëm, me synim identifikimin në kohë të masave korrektuese të politikës monetare. Në çdo rast, dëshiroj t'ju siguroj se politika monetare e Bankës së Shqipërisë do të synojë të marrë vendimet e duhura në kohën e duhur, për t'i garantuar vendit stabilitetin e çmimeve me një kosto sa më minimale në terma të volatilitetit ekonomik dhe financiar.

